



2453

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 2258 / Prot.Tiranë, më 03.05.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Z. DORIAN MATLIJA
QENDRA "RES PUBLICA"
E-mail: gendra.respublica@gmail.com

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 19 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe me aktin nr. 2258 prot., datë 19.04.2024, referuar ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 18.04.2024 mori në shqyrtim kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për caktimin e masës disiplinore "shkarkim nga detyra" për magjistratin Arben Dosti, duke vendosur rrëzimin e saj.

Për sa më sipër, ju bëjmë me dije se, në zbatim të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të Rregullores për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor, miratuar me vendimin e tij nr. 316, datë 14.09.2020, Këshilli shpall vendimin e arsyetuar i cili publikohet në faqen zyrtare të internetit të tij, duke u anonimizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vendimi i arsyetuar përmban në mënyrë të detajuar rrethanat e fakteve, provat e administruara, vlerën provuese të tyre, apo llojin e shkeljes disiplinore.

Për këto arsye, bazuar në pikën 1, të nenit 16 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, në kushtet kur trajtimi i kërkesës tuaj për informacion kërkon më shumë kohë se afati i parashikuar në pikën 1, të nenit 14, të këtij ligji, ju bëjmë me dije se, dokumentacionin e kërkuar do t'ju vendosim në dispozicion menjëherë pas zbardhjes së vendimit të arsyetuar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

RUDIN BAQLI